



KOMUNA E KLINËS
KUVENDI I KOMUNËS

01. Nr. 06-5056 / 116
KLINË, 15.12.2016

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

I MBLEDHJES SE DEBATIT ME PUBLIKUN , MBAJTUR MË 15.12.2016, NË ORËN
10.00, NË SALLËN E KK

Në mbledhje prezantuan: Kryesuesi i KK, Dr. Haxhi Ibishi, nënkryetari i Komunës, Enver Berisha, drejtorë të drejtorive, Zyra ligjore, drejtorë të shkollave, OJQ "Koha", 60 e me teper qytetarë , prej tyre 7 femra.

Mbledhjen e hapi kryesuesi i KK, Dr. haxhi Ibishi, i cili fillimisht i përshëndeti të pranishmit dhe i falënderoi për pjesëmarrje në këtë takim me qytetarët. Dr. Ibishi në vazhdim foli për rëndësinë që ka organizimi i këtyre debateve me qytetarët, me qëllim të përcjelljes së menaxhimit të qeverisjes komunale nga ana e qytetarëve, po ashtu shtoi se me pjesëmarrjen e qytetarëve në këto debate po krijohet një kulturë e komunikimit në mes të qytetarëve dhe pushtetit lokal, në mënyrë që qytetarët të kenë qasje në vendimmarrje.

Kryesuesi Ibishi prezantoi dy pikat e

RENDIT TË DITËS

1. Shqyrtimi i projekt-rregullores për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të palestrës sportive "Adem Jashari" në Klinë,
2. Plani i Zhvillimit të Arsimit për periudhën 2017-2019.

Kryesuesi foli rreth pikave të rendit të ditës. “Diskutimet tuaja do të dërgohen nëpër drejtoritë përkatëse, do të procedohen në KPF dhe pastaj në KK , ku do të bëhet shqyrtimi dhe miratimi i këtyre dy dokumenteve”, shtoi Kryesuesi.

1. Pika e parë: Shqyrtimi i projekt-rregullore për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të palestrës sportive “Adem Jashari” në Klinë.

Kryesuesi hapi diskutimin rreth pikës së parë të rendit të ditës. Fjalën e barti te drejtoresha e DKRS, znj. **Kristina Lazri**.

Kristina Lazri, foli rreth projekt-rregullore, mënyrës dhe kushteve të shfrytëzimit të palestrës sportive “Adem Jashari” në Klinë.

“Para jush kemi projekt-rregulloren për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të palestrës sportive “Adem Jashari” në Klinë. Palestra është në funksion dhe i plotëson të gjitha kushtet për t’u miratuar kjo rregullore. Të jepni mendimet tuaja, sugjerimet dhe vërejtjet, të cilat do të merren në konsideratë”, shtoi ndër të tjera drejtoresha Lazri.

Haxhi Ibishi, hapi diskutimin rreth pikës në shqyrtim.

Refki Krasniqi, përkthyes në KK:

Vërejtja 1 dhe vërejtja më kryesore: **nuk ka kosto financiare të zbatimit të rregullore**, nuk ka një parashikim të shpenzimeve mujore-vjetore të menaxhimit dhe mirëmbajtjes së sallës, nuk ka plan sa veta do të punësohen, sa do të jenë shpenzimet për pagat e tyre, sa parashihen të jenë shpenzimet mujore të rrymës së harxhuar, ujit dhe mbeturinave. Në bazë të këtyre kalkulimeve do të duhet që pastaj të bëhet plani apo përcaktimi i kushteve dhe pagesave për shfrytëzim.

Vërejtja 2: neni 3, pika c është pothuajse e njëjtë me nenin 6, paragrafi 1.

Vërejtja 3: neni 4 dhe neni 5 kanë do të mund të sjellin një situatë (hipotetike) të tillë: çka nëse një shfrytëzues potencial që vjen jashtë Kline kërkon të përdorë sallën në të njëjtën kohë me një shfrytëzues nga Klina? A do të i jepet këtij jashtë Kline që paguan 50 Euro në orë apo këtij nga Klina që paguan 10 apo 15 Euro në orë? **Vërejtja 4**, neni 3 në përmbajtje. Kush do të shet biletat, kush kontrollon numrin e biletave të shitura në mënyrë që të përcaktohet 30% i biletave të shitura? Pagesa fikse sipas marrëveshjes lejon mundësinë e bërjes “Pazar” në këtë rast apo? E në “Pazar” ka plot hapësirë për korrupsion?”- ka shtuar Krasniqi.

Sejdi Desku, arsimtar në shkollën e Siqevës, tha se drejtoresha është e njoftuar me disa mangësi që ekzistojnë në Palestrën Sportive. “Salla nuk ka inventar, a do të pajiset me inventar? Po ashtu, secili klub të ketë çelësat për zhveshtore.

Haxhi Ibishi, tha se kjo projekt – rregullore do të përpunohet, ndërkaq vërejtjet e e dhëna do të gjejnë vend për ripërpunim.

Pika e dytë: Plani i Zhvillimit të Arsimit për periudhën 2017-2019.

Kryesuesi Ibishi foli rreth Planit të Zhvillimit të Arsimit për periudhën 2017-2019. Fjalën për raportim e barti të prof. Hajdin Morina, drejtor i DKA.

Hajdin Morina, drejtor i DKA, raportoi rreth planit. “Ky plan ka kaluar nëpër institucionet legjislative, është plan transparent që do të debatohet para qytetarëve. Ky plan është hartuar me ndihmën e përfaqësuesve ndërkombëtarë, përkatësisht të zotit Alan Packer, ekspert i angazhuar nga GIZ-i. Është një formë unike. Nuk i kemi paraqitur asgjë më shumë se sa atë që drejtorët e shkollave kërkojnë nga ne, po ashtu edhe ne nga institucionet e larta. Nuk kemi mundur të ndërtojmë më shumë në këtë plan. Janë prekur fushat që arsimi duhet t’i ketë. Jemi duke bërë përpjekje për t’i zënë trendët evropiane në fushën e arsimit. Për një klimë të tillë nuk i kanë fajet vetëm institucionet, por përgjegjësia është e të gjithëve, por edhe e prindërve, sepse fëmijët mësojnë edhe në shtëpi. Kjo rregullore do të jetë një hap për arsimin në Klinë, që jo prinë të gjitha veprimtaritë tjera. S’ka ekonomi pa arsim. Jemi munduar që të jemi afër jush. Besoj se arsimi do të jetë më mirë”, shtoi ndër të tjera drejtori Morina.

Kryesuesi Ibishi, hapi debatin.

Enver Berisha, nënkryetar i Komunës, foli rreth rëndësisë që ka kjo rregullore në ngritjen e efikasitetit dhe të cilësisë në arsim. Nënkryetari Berisha fillimisht falënderoi drejtorin e DKA-së, prof. Hajdin Morinën, për angazhimin dhe kujdesin e tij për t’u marrë me këtë problematikë të arsimit, që është hallka më e rëndësishme për zhvillimin e arsimit.

“Ne si Komunë kemi bërë përpjekje të vazhdueshme për një infrastrukturë shkollore, duke ndërtuar disa shkolla të reja, mirëpo duhet punuar akoma më shumë për të krijuar kushte për nivel më të lartë të arsimit në komunën tonë. Komuna e Klinës është në nivelin mesatar me tendencë të rritjes së sukseseve të tjera në vijimësi. Të jemi më përgjegjës në obligime. Të mos na kurseni si Komunë, ku ka pengesa të jemi bashkë. Edhe në kuadër të SZHA arsimi do të ketë një vend të veçantë për të ardhmen e arsimit dhe të Komunës sonë”, ka konstatuar mes tjera nënkryetari Berisha.

Elbasan Raci, OJQ “Koha”, tha se ne si organizatë kemi marrë hapin që t’i ftojme qytetarët për të marrë pjesë në këtë debat të sotëm, mirëpo është mungesa materiale. “Rregulloren po e marr tash, prandaj nuk m’u dha rasti për ta lexuar. Kisha dashur që drejtoresha të jap një ekspozë më të gjerë, sepse nuk kemi njohur se çfarë ngërthen kjo rregullore”, tha z. Raci.

Marjan Gojani (Jagodë), shtroi problematikën me të cilat ballafaqohet shkolla fillore e Jagodës, kulmin kancerogjen, mungesën e ujit, të tualeteve, rrethojës etj. Zoti Gojani kërkoi që të ndërmerret diçka në rregullimin e tyre.

Gani Ahmetxhekaj, drejtor ne sh.f. "Ismet Raci", foli rreth diç çështjeve që kanë të bëjnë me arsimin në Komunën e Klinës. "Mendoj që në shikim të parë duhet rregulluar pozitën infrastrukture, që mundëson zhvillimin e kurrekulës, në mënyrë që të kemi një arsim më të avancuar. Drejtori Ahmetxhekaj përkoj që të parashihen në plan ekipet për vlerësim të brendshëm dhe planet e komitetit të të mësuarit së bashku.

Xhafer Bashota, drejtor i gjimnazit "Luigj Gurakuqi", foli rreth dobësive që po paraqiten në shkollat tona. "Shkolla paraqet një hallkë ku inkorporohen prindi, nxënësi dhe komuna. Objektet ndërtohen me para, mirëpo mësimdhënësi duhet ta dnërtojë veten e tij. Sot arsimtarët në shkollat tona nxënësve ju japin shënime, me qëllim të disiplinimit të nxënësve. Shkollat janë të politizuara. Shumë mësimdhënës kanë marrë shkollat pas lufte, pas darke, prandaj edhe janë të paaftë për të kryer detyrat dhe përgjegjësitë që ju takojnë. Propozoj që në kuadër të Komunës të krijohet një institucion i inspektorëve në mënyrë që ata të kontrollojnë punën e mësimdhënësve. Duhet angazhuar të gjithë për një avancim në arsim. Reformë është përgatitja e mësimdhënësve. Të angazhohemi të gjithë në mënyrë që prej vitit të ardhshëm shkollor të sjellim suksese të reja. Të kërkojmë raporte, çdo drejtor për mësimdhënësit. Nuk është çdo gjë zi, mirëpo ka vend për punë më efektive", tha drejtori Bashota.

Haxhi Ibishi, tha se e kemi strategjinë për ta shqyrtuar, të mos dalim nga tema bosht e shqyrtimit të planit zhvillimor. "Punësimi në arsim nuk mund të jetë punësim social. Kjo situatë është duke na përcjellë që 17 vjet. SZHA duhet shndërruar në parametra të shëndoshë. Është turp të dal ai vlerësim i Pisës", tha kryesuesi Ibishi.

Sejdi Baleci, Grabanicë, thoi se nuk çn peshë PZHA, me rëndësi është që dija të mbërrijë tek nxënësi ynë. "Faji është edhe i familjes, është i përbashkët. Ka kuadro që nuk meritojnë të punojnë në arsim. Kemi nevojë për kuadro të aftësuar, sepse këta nxënës janë e ardhmja e këtij vendi, nesër ata kanë për të udhëhequr këtë vend", tha z. Baleci.

Haxhi Raci, Jelloc, foli rreth disa dobësive që paraqiten në arsimin tonë. "S'ka PZH pa statistikë. Në këtë formë s'ka zhvillim. Nuk dimë për cilësinë në shkollat e komunës së Klinës dhe pa ditur nivelin e cilësisë nuk mund të hartojmë PZHA. Shoqëria e sotme po na degradon në këtë formë. Duhet të respektohet ligji. Zhvillimin e arsimit duhet trajtuar ndryshe", shtoi ai.

Naim Musliu, drejt i SHF "Isa Boletini" në Drenoc, foli rreth disa çështjeve në arsim, ku sipas tij arsimit në komunën e Klinës nuk është në atë gjendje çfarë u vlerësua nga disa diskutues. Në vijim drejtori Musliu foli edhe për mungesën e sekretarëve nëpër disa shkolla, si të Drenocit, Poterqit, Grabanicës dhe kërkoj që të sistemohet një vend punë për sekretar shkollë i cili do të punonte në disa shkolla.

Sami Elezi, Shkolla e Mesme Teknike, tha se gjendja në shkolla nuk është e tillë çfarë po vlerësohet këtu, shtoi ai, i cili në vijim kërkoi që të formohet një Komision i prindërve që do të përcjellte punën dhe suksesin e nxënësve. "Nuk fajësohet tërësisht personali arsimor", tha ai.

Haxhi Ibishi, shtroi nevojën e organizimit të një tryeze për të debatuar rreth çështjes së arsimit.

Tunë Dedaj, foli në emër të këshillit të prindërve, rreth keqpërdorimeve të tenderëve, ku pranimi i punëve të operatorëve bëhet pa u kryer punët. Zoti Dedaj po ashtu foli edhe rreth problemeve infrastrukturore me të cilat përballet shkolla e Jagodës dhe kërkoi nga organet gjegjëse që të ndërmerret diçka konkrete në sanimin e tyre. “Prindërit janë të shqetësuar për punët dhe ecurit e arsimit në shkollat tona. Si kërkesë kam që të ndriçohet rruga që shpie në drejtim të Shkollës së mesme Teknike”, shtoi Dedaj.

Hysni Rraci, zv.drejt i shkollës fillore “Ismet Rraci” në Klinë foli rreth shumë çështjeve që lidhen me arsimi në Komunën e Klinës. Profesor Rraci kërkoi që në shkolla të ketë pedagogë dhe psikologë, po ashtu edhe inspektorët të përcjellin punën e mësimdhënësve, qysh ka qenë më parë. Po ashtu ai si propozim konkret dha edhe formimin e grupit për vlerësim, që sipas tij jo si grup formal, por të krijohet në nivel komunal ose regjional. “Është mirë që për çështje të tilla tepër të rëndësishme të organizohen tryeza tematike”, shtoi prof. Rraci.

Haxhi Ibishi, tha se le të jetë si obligim organizimi i tryezës tematike. “Të përgatitet një platformë afatgjatë”, shtoi kryesuesi Ibishi.

Hajdin Morina, drejtor i arsimit në Komunën e Klinës, sqaroi çështjet e ngritura nga pjesëmarrësit. “Çështja e Jagodës është në strategji, edhe çështja e rrethojave janë me prioritet dhe do të plotësohet kjo kërkesë e shkollave; kemi paraparë pedagogët dhe psikologët nëpër shkollat tona; ekipet janë duke punuar me kurrikulë; koordinatorët e cilësisë formohen nga ministria. “Kemi futur në prioritet çështjet që janë më të rëndësishme. Më mirë të punohet se sa të mbesin në sirtar këto plane. Problemi i komunikimit na shkakton probleme. Ky plan ka për t’u plotësuar me vërejtjet e juaja. Të shkojmë kah cilësia. Faji është i përbashkët. Vlerësimi i Pisës nuk është tërësisht i besueshëm, meqenëse vërejtjet duhet marrë në konsideratë. Janë dhënë miliona për zhvillimin dhe përparimin e arsimit. Ne kemi nevojë për të qenë më mirë. Duhet të mobilizohemi për arritje më të mëdha”, shtoi ndër të tjera drejtori Morina.

Rrustem Sferka, foli rreth shumë çështjeve që preokupojnë arsimin tonë. “të mos përgjithësohen gjerat. Kush e udhëhoq PIsën në Klinë dhe në Kosovë. Kanë ndikuar më të madhe në këtë vlerësim. Si i gjeti Pista këta nxënës që nuk dinë shkrim-lexim? Ata kanë pasur njohuri të mëhershme. Mungon bashkëpunimi në trekëndëshin mësues-prind-nxënës. Mungojnë kushtet në shkolla. Derisa nuk ndëshkohet nxënësit nuk ka suksese në shkollat tona”, shtoi ndër të tjera prof. Sferka.

Sejdi Desku, foli rreth disa çështjeve në arsim që po krijojnë telashe. “Pisa na ka krijuar telashe”, tha ndër të tjera, z. Desku, i cili në vijim përsëriti edhe një herë çështjen e palestrës sportive.

Enver Berisha, Volljak, shtroi çështjen e nevojës së hapësirave sportive në shkollën e Volljakut, po ashtu edhe për shkollën e Përqevës.

Elbasan Raci, reagoi lidhur me lëshimin e debatit të drejtorit të Arsimit, z. Morina. “Çfarë të bisedojmë këtu kur drejtori i Arsimit nuk është këtu. Pyetje: Çka me shkollën fillore “Ismet Rraci” në Klinë? Ne si organizatë e joqeveritare jemi të interesuar të dimë lidhur me ndërtimin e kësaj shkolle, përkatësisht se a do të zhvendoset objekti i kësaj shkolle në kompleksin e shkollave. Është një amulli rreth kësaj çështjeje se çfarë do të ndodh me këtë shkollë”, tha z. Raci.

Haxhi Ibishi, sqaroi çështjen e ndërtimit të shkollës fillore “Ismet Raci” në Klinë. Shkolla fillore Ismet Rraci nuk kam dëshirë që të politizohet. Na nevojitet mendimi profesional. T’i lejojmë njerëzit profesional që ta thonë mendimin e tyre. Nuk ka informacione zyrtare rreth zhvendosjes së shkollës. Edhe Kryetari edhe AK janë të interesuar për ta ndërtuar shkollën.

Gjon Palushaj, Klinë, tha se Pisa nuk është fajtor për degradimin e arsimit në Kosovë, të mësojmë nga gabimet. “Ka mundësi të punohet më shumë”, tha ai.

Faruk Mulaj, mësimdhënës në SHMT “Fehmi Agani”, foli rreth braktisjes shkollës nga ana e nxënësve dhe kërkoi se si të parandalohet ky trend i braktisjes së tyre që po i bëjnë shkollës. “Cilat masa do t’i ndërmer DKA rreth këtij fenomeni?” shtroi pyetjen ai.

Ndue Gjergjaj, drejtor i sh.f. Në Jagodë, foli rreth çështjeve të mungesës infrastrukturore në shkollën që ai udhëheq. Në vijim ai tha se nuk pajtohet me disa konstatime që në arsimin tonë është çdo gjë zi. Sipas drejtorit Gjergjaj arsimi në komunën e Klinës ka rezultate të shumta dhe si dëshmi potencoi disa suksese të shkollave të komunës së Klinës në garat republikane dhe jashtë në disa fusha të arsimit.

Tunë Dedaj asamblist, tha se nuk mora përgjigje rreth pyetjes së shtruar. “Largimi i drejtorit të Arsimit nga debati i sotëm është veprim fyes për qytetarët”, tha ai.


Kristina Lazri, foli rreth çështjeve të ngritura të Sejdi Deskut, rreth palestrës sportive. “E kam marrë seriozisht shqetësimin tuaj. MKRA është përgjegjëse, neve vetëm na u janë dhënë çelësat, ata kanë investuar projektin. Kërkesën ia kam dërguar departamentit të Sportit dhe pres përgjigjen e tyre. Jemi të pafuqishëm për të intervenuar atje. Edhe çështja e inventarizimit, po presim të ministrisë. Nëse më 2017 nuk hapin tender do ta rregullojmë vetë”, sqaroi drejtoresha Lazri.

Kryesuesi falënderoi pjesëmarrësit për kontributin e dhënë.

Takimi e konstatoi të mbyllur.

Takimi përfundoi në orën 12:00.

Procesmbajtësi,
Mikel GOJANI



Kryesuesi i Takimit,
Dr. Haxhi Ibishi

